



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË – Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Penal, gjyqtari Driton Sadiku, me sekretaren juridike Mandushe Doli, në çështjen penale ndaj të pandehurës A.D., nga Peja, me vendbanim në Gjakovë, për shkak të veprës penale lëndim i lehet trupor nga neni 185 par.1 nepar.1.4 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (në vazhdim KPRK-së), si dhe ndaj të pandehurës A.R., nga Peja, për shkak të veprës penale sulmi nga neni 184 par.1 të KPRK-së, të akuzuara sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjakovë – Departamenti i Përgjithshëm, PP/II.nr.1696/2023, të datës 28.12.2023, duke vendosur për marrëveshjen e ndërmjetësimit Nd.nr.20/2024 e datës 04.03.2024, jashtë seancës, me datën 17.03.2024 mori këtë:

A K T V E N D I M

APROVOHET marrëveshja e ndërmjetësimit Nd.nr. 20/2024 e datës 04.03.2024, e lidhur në mes të pandehurës - dëmtuarës A.D., nga Peja, me vendbanim në Gjakovë, në rrugën "...", p.n, si dhe të pandehurës - demtuarës A.R., nga Peja, rruga "...” nr.71, ashtu që;

HEDHET aktakuza e Prokurorisë Themelore në Gjakovë – Departamenti i Përgjithshëm PP/II.nr.1696/2023, të datës 28.12.2023 dhe PUSHOHET procedura penale ndaj të pandehurës - dëmtuarës A.D., për shkak të veprës penale lëndim i lehet trupor nga neni 185 par.1 nepar.1.4 të KPRK-së dhe të pandehurës – dëmtuarës A.R., për shkak të veprës penale sulmi nga neni 184 par.1 të KPRK-së, pasi që palët kanë arritur marrëveshje në procedurën e ndërmjetësimit.

Shpenzimet e procedurës penale bien në barrë të mjeteve buxhetore të kësaj gjykate

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Gjakovë – Departamenti i Përgjithshëm, në këtë gjykatë ka ngritur aktakuzën PP/II.nr.1696/2023, të datës 28.12.2023, ndaj të pandehurës A.D., për shkak të veprës penale lëndim i lehet trupor nga neni 185 par.1 nepar.1.4 të KPRK-së, si dhe ndaj të pandehurës A.R., nga Peja, për shkak të veprës penale sulmi nga neni 184 par.1 të KPRK-së

Gjykata ka caktuar dhe mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar me datën 01.03.2024 në të cilën seancë kanë marrë pjesë Prokurori i shtetit Azem Islamaj, të pandehurat A.D., dhe A.R., ku pas leximit të aktakuzës gjykata i njoftoj palët lidhur me mundësin e zgjidhjes së kësaj çështje penale në procedurën e ndërmjetësimit, ashtu që të pandehurat propozuan që kjo çështje të referohet në procedurën e ndërmjetësimit, po ashtu me këtë propozim u pajtua edhe prokurori i shtetit, për çka gjykata aprovoj propozimin e tyre dhe këtë çështje penale e referoj në procedurën e ndërmjetësimit.

Me datën 04.03.2024, në Gjykatën Themelore në Gjakovë, në prezencën e ndërmjetësuesit B.RR., palët kanë arritur marrëveshje për fillimin e procedurës së ndërmjetësimit, duke deklaruar se e kuptojnë procedurën e ndërmjetësimit dhe vullnetarisht pajtohen që ta fillojnë këtë procedurë, pajtohen që të përmbahen nga ndonjë veprim tjetër juridik gjatë procedurës së ndërmjetësimit, janë informuar dhe i pranojnë shpenzimet e procedurës, përfshirë tarifën e ndërmjetësimit.

Po ashtu në të njëjtën ditë në mes të palëve është arritur edhe marrëveshja për zgjidhjen e kësaj çështje penale në procedurën e ndërmjetësimit, ku e pandehura A.D., ka deklaruar se ndjehet e penduar pe veprën e kryer, duke shprehur keqardhje dhe kërkim falje për te dëmtuarën A.R., Po ashtu e pandehura A.R., ka deklaruar se ndjehet e penduar për veprën e kryer, duke shprehur keqardhje dhe kërkim falje për të dëmtuarën A.D., ashtu që këtë marrëveshje me vendimin Nr.nr.20/2024 të datës 04.03.2024 e ka pranuar ndërmjetësuesi B.RR.,...

Gjykata duke parasysh që palët kanë arritur marrëveshjen në procedurën e ndërmjetësimit, pas vlerësimit të marrëveshjes, duke vepruar në bazë të dispozitave të nenit 15 të Ligjit për ndërmjetësim e aprovoi këtë marrëveshje pasi që vlerësoj se e njëjta është lidhur me vullnetin e plotë të palëve në konflikt dhe në pajtim me ligjin në fuqi, e cila marrëveshje në bazë të nenit 15 të Ligjit për Ndërmjetësimin, do të ketë fuqinë e dokumentit përmbarues nga data e aprovimit nga gjykata.

Vendimi lidhur me shpenzimet e procedurës është marr në bazë të nenit 453 par.1 të KPP-së

Gjykata duke u bazuar nga të cekurat si më lartë dhe në bazë të nenin 357 par.1 nënpar.1.3 të KPP-së dhe nenit 11 të Ligjit për Ndërmjetësim vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË

Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal

2023:304898, me datën 05.03.2024

Sekretarja juridike,
Mandushe Doli

Gjyqtari,
Driton Sadiku

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa në afat prej tre (3) ditësh nga dita e marrjes së aktvendimit, në Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate.